

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN RISHTINA”
FAKULTETI JURIDIK
STUDIMET POSTDIPLOMATIKE-MASTER
PROGRAMI “E DREJTA CIVILE DHE PRONËSORE”



PUNIMI I DIPLOMËS MASTER

TEMA: “MARTESAT NËN MOSHËN MADHORE, PROBLEMET PRAKTIKE”

Mentori:
Prof.Asoc.Dr.Bedri Bahtiri

Kandidatja:
Haka Emini

Prishtinë, prill 2024

Abstrakti

Ky punim diplome trajton martesat nën moshë madhore, me fokus të veçantë në problemet praktike të tyre që shprehen si probleme teorike, ligjore dhe shoqërore. Punimi fokusohet në trajtimin e aspekteve teorike, ligjore dhe praktike të shpjegimit të martesave nën moshë madhore dhe dukurive me të cilat sinonimizohen, më pas raportet e të drejtës së martesës me të drejtat e fëmijëve, obligimet e shtetit në mbrojtje të fëmijëve, institutin e martesës dhe kriterin e moshës, për të vazhduar me lejimin e martesës për një kategori të fëmijëve, procedurën e dhënies së lejes nga Gjykata, dhe përmbillet me trajtimin e problematikave në veçanti, duke dhënë në fund konkluzionet dhe rekomandimet ideale për përfundimin e këtyre martesave.

Meqenëse subjekte të këtyre martesave janë fëmijët, këto martesë është menduar që të trajtohen në mënyrë sa më objektive, gjithëpërfshirëse, racionale, me konsideratë dhe vëmendje ndaj faktit se martesë për fëmijët është dukuri negative e dëmshme për shëndetin, integritetin dhe mirëqenien e tyre. Andaj, fokusi kryesor është analizimi i shkaqeve të martesave të fëmijëve dhe ofrimi i zgjidhjeve në eliminimin e tyre, e tërë këto me argumentimin bazë se përfundimi i martesave nën moshën madhore është në interesin më të mirë të fëmijëve.

Qëllimi primar që ndjek tema e studimit është definimi i martesës nën moshën madhore dhe argumentimi i problemeve praktike që i paraprijnë lidhjes së këtyre martesave dhe problemeve praktike që vijnë si rezultat i lidhjes së tyre. Ky hulumtim është i formës shpjeguese, analizuese dhe argumentuese ngase edhe tema kërkon trajtime të tilla.

Fjalët kyçe: Fëmijë, i mitur, martesë nën moshën madhore, martesë e fëmijëve, mosha për martesë, aftësia për martesë, vullneti për martesë, interesi më i mirë i fëmijëve, dhënia e lejes për martesë.